

Raport përmbledhës mbi pyetëtorin

*“Formular vlerësimi nga
studentët i mësimdhënies
në distancë”*

Semestri i dytë

Viti akademik

2020-2021

**Njësia e Sigurimit të Cilësisë
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**





Lista e shkurtesave

FGJH - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

NJSC - Njësia e Sigurimit të Cilësisë

IAL - Institucion i Arsimit të Lartë



Përmbajtja e pyetësorit	Error! Bookmark not defined.
Gjetjet e pyetësorit	Error! Bookmark not defined.
1. PËRMBAJTJA DHE ORGANIZIMI I LËNDËS	Error! Bookmark not defined.
2. PJESËMARRJA E STUDENTIT NË MËSIM	Error! Bookmark not defined.
3. MJEDISI I TË NXËNIT DHE METODAT E MËSIMDHËNIES	Error! Bookmark not defined.
4. BURIMET E TË NXËNIT	Error! Bookmark not defined.
5. DETYRAT	Error! Bookmark not defined.
6. VLERËSIMI	Error! Bookmark not defined.
7. MBËSHTETJA ME SHERBIMIN IT	Error! Bookmark not defined.

Në zbatim të Rregullores për Sigurimin e Cilësisë në UT, në periudhën 9.06.2021 deri 22.06.2021 grupi i punës i ngritur për vlerësimin e mësimdhënies në distancë për semestrin e dytë, ndërtoi një pyetësor (*Shtojca Nr. 1*), të miratuar më pas si të tillë në Mbledhje Dekanati, më 12.04.2021. Zyra IT e FGHJ-së u kujdes për shpërndarjen e tij elektronike nëpërmjet platformës TEAMS (forms) tek studentët e programeve Bachelor dhe Master të Fakultetit tonë si edhe përpunimin e të dhënave.

PËRMBAJTJA E PYETËSORIT

Pyetësori “*Formular vlerësimi nga studentët i mësimdhënies në distancë*” përbëhet nga 35 pyetje të shtrira në seksionet kryesore:

- I. Përmbajtjen dhe organizimin e lëndës
- II. Pjesëmarrjen e studentin në mësim
- III. Mjedisi i të nxënit dhe metodat e mësimdhënies
- IV. Burimet e të nxënit
- V. Detyrat
- VI. Vlerësimi
- VII. Mbështetja me shërbimin IT

Studentët duhet të rrethonin nga numri 1(një) deri ne 5(pesë), ku 1 është shkalla e ulët e vlerësimit dhe 5 shkalla me e lartë, si edhe alternativa *Nuk e di*. Gjithashtu, pas çdo pyetjeje në alternativën *Komento* studentët kishin mundësi të jepnin mendimin e tyre ne lidhje me mësimdhënien *on line*.

GJETJET E PYETËSORIT

Pas gjenerimit automatik të të dhënave (*Shtojca Nr. 2*), rezultoi se nga numri total i studentëve, respektivisht Cikli I:1770, Cikli II: 897, ky pyetësor u plotësua nga 514 studentë, ose 19,27% e studentëve, prej të cilëve 353 janë studentë nga programet Bachelor dhe 156 janë studentë nga programet Master.

I. PËRMBAJTJA DHE ORGANIZIMI I LËNDËS

Synimi i pyetjeve në këtë pjesë ishte të analizonim mendimin dhe vlerësimet e studentëve në lidhje me njohjen e tyre me objektivat e lëndëve ku 25,29% dhe 28.4% e studentëve i vlerësojnë ato si të qarta, ndërsa 9.721% dhe 7% mendojnë se këto objektiva nuk janë të qarta.

Shpërndarja e përqindjes së studentëve për *ngarkesën e përballueshme të lëndëve* është pothuajse e njëjtë duke variuar nga 12,45 % deri ne 20.23 %. Afërsisht 49.02 % e studentëve (23.34% dhe 25.68 %) shënojnë se *lënda është organizuar mirë*, ndërsa afërsisht 23.73% shënojnë vlerësimin më të ulët për këtë komponent.

II. PJESËMARRJA E STUDENTIT NË MËSIM

Nga të dhënat e përpunuara në këtë seksion ka dalë se studentët kanë *ndjekur orët e mësimimit* në masën 50.38% dhe pjesëmarrja në mësim varion nga më e ulëta 7.58% deri në 32,1% që shënojnë se kanë marrë pjesë aktive në mësim. Kjo përqindje në frekuentim reflektohet edhe në *përparimin e studentëve* në

mësimin *online*. Vihet re se përqindja e studentëve që e konsiderojnë *të ulët përftimin dhe përparimin* është e madhe 21,4% dhe 12,25% dhe ata që kanë përftuar shumë është në masën 18.67%.

III. MJEDISI I TË NXËNIT DHE METODAT E MËSIMDHËNIES

Në këtë seksion vlerësohet *strukturimi i lëndëve (balancim i mirë ndërmjet leksioneve, seminareve, detyrave dhe konsultimeve etj)*. 12.06% dhe 10.89% e studentëve mendojnë se balancimi nuk është në nivelin e duhur ndërkohë që 25,29% e 19,64% e shënojnë me 4 dhe 5, pra, në nivel të lartë.

IV. BURIMET E TË NXËNIT

Të dhënat e pyetësorëve tregojnë se studentët vlerësojnë se *materialet mësimore (teksti, leksionet, materialet ndihmëse për lëndën etj.) librat e rekomanduar* ishin të rëndësishme dhe të përshtatshme. Gjithashtu *ofrimi i burimeve të të nxënësve në Internet* ishte i mjaftueshëm. Nga 487 përgjigje të dhëna për këtë kategori (pra nga rreth 95% e totalit të përgjigjeve të dhëna), vlerësimet me (4) dhe (5) shënohen respektivisht nga 28.3% deri 26.8 % e studentëve. Por shënimi nga afërsisht 18% e studentëve me (1) ose (2) tregon se jo të gjitha materialet konsiderohen të mjaftueshme nga studentët. Nga komentet vihet re se mjaft studentë i quajnë të dobishme dhe të mjaftueshme materialet, të tjerët të ngarkuara ose të pa përshtatura për ta.

V. DETYRAT

Dobia e detyrave të ngarkuara vlerësohen si të dobishme me shkallën e mëposhtme nga 481 përgjigje të dhëna (nga rreth 94% e totalit):

1-9,3% , (2) 9,7%, (3) 20,9%, (4) 29,3%, (5) 28,2%. Pothuajse me të njëjta vlera shënohet *puna e pavarur për kryerjen e tyre* si edhe *qartësia e udhëzimeve të dhëna për kryerjen e tyre*.

Nga komentet rezulton se studentët në përgjithësi i vlerësojnë detyrat në përvetësimin e lëndës, por një pjesë shprehen se janë të ngarkuara, dhe me pak kohë në dispozicion dhe me vështirësi në rritje sepse iu duhet të punojnë me celular e shpejtësia apo aksesi në internet përbënte problem.

VI. VLERËSIMI

Në lidhje me *shumëllojshmërinë dhe përshtatshmërinë e metodave të vlerësimit* 26,6% dhe 22,2% e studenteve shënojnë se janë të mirë dhe shumë të mirë, vlerësuar respektivisht me (4) dhe (5), ndërsa 10,6% dhe 12,2% i shënojnë me (1) dhe (2) duke treguar se nuk janë dakord me këto metoda vlerësimi. Një problem që del në pah dhe që është shumë i ndjeshëm për studentët është *dhënia e vlerësimit në kohë*. Respektivisht 14,1% dhe 8,7% (1) dhe (2) mendojnë se kjo nuk bëhet në kohë, gjë që del edhe në komentet e shkruara nga studentët.

VII. MBËSHTETJA ME SHERBIMIN IT

Komponenti që lidhet me këtë seksion *Mbështetja e procesit mësimor nga regjistrimi në platformën TEAMS* dhe gjatë zhvillimit të mësimit dhe provimeve vlerësohet me (5) nga 40,2% e studentëve. Vetëm 10,1% e tyre janë të pakënaqur nga ky shërbim ndërsa 17,2% shënojnë nuk e di. Kjo për faktin se ata i kanë përballuar vetë problemet e tyre. IT e Ut-së dhe Fakultetit ka vepruar në kohë reale, pavarësisht nga orari për të zgjidhur problemet e studentëve me platformën TEAMS.

REKOMANDIME

1. Duke patur parasysh kushtet e jashtëzakonshme gjatë të cilave është organizuar dhe realizuar procesi mësimor, duket se pjesa më e madhe e studentëve e konsiderojnë lëndën të realizuar mirë dhe me ngarkesë të përballueshme, por nga gjetjet ka vend ende për përmirësim në drejtim të përmbajtjes dhe organizimit të lëndës që në fillim të procesit mësimor.
2. Për këtë pikë rekomandohet fort që të ofrohen më shumë shërbime mbështetëse në ndihmë të studentëve dhe pedagogëve, me në fokus nxitjen e procesit të të nxënurit përmes mjeteve dhe teknologjisë digjitale; si dhe programe trajnimi të vazhdueshme dhe në vazhdimësi.
3. Këto të dhëna tregojnë se pavarësisht punës që bëhet duhet të përqendrohemi në komunikimin më mbështetës dhe nxitës për studentët. Nga komentet e bëra nga student vihet re se një pjesë e mirë e tyre vlerësojnë punën që bëhet për shpjegimin dhe aktivizimin e studentëve në mësimin online. Rekomandohet që të gjenden, nga ana e stafit akademik më shumë metoda motivuese për të nxitur pjesëmarrjen dhe aktivizimin e studentëve në procesin mësimor.
4. Bazuar tek komentet e studentëve në lidhje me detyrat dhe përmbushjen e tyre, rekomandohet që të jepen udhëzime më të detajuara për detyrat që u ngarkohen sipas programit të përcaktuar, duke i kushtuar vëmendje mundësive teknike dhe fizike që studentët kanë.
5. Rekomandohet që të ketë komunikim më të ngushtë mes studentëve dhe stafit akademik dhe të ndiqet zbatimi i rregulloreve përkatëse në fuqi. Rekomandohet gjithashtu se vlerësimi që u komunikohet studentëve të jetë i arsyetuar. Në lidhje me ndryshimet e mundshme që propozojnë studentët është pranimit i mësimit në distancë si mjet alternativ dhe plotësues i mësimit me prezencë fizike.
6. Për mbështetjen me shërbimin IT, rekomandohet që të vazhdohet me të njëjtin intensitet pasi në këtë mënyrë garantohet edhe pajisja e studentëve me aftësi të përdorimit të teknologjisë digjitale për qëllime të të nxënurit.

Hartoi NJSBC në FGJH